



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.176

dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.850, datë 14.12.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.23, datë 12.1.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisve dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit European, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), komponenti I, asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional.....	9981
Vendim i KM nr.860, datë 14.12.2011	Për pranimin e rritjes së kuotës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar.....	9982
Vendim i KM nr.861, datë 14.12.2011	Për rishpërndarje fondesh, ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	9983
Vendim i KM nr.862, datë 19.12.2011	Për një shtesë në vendimin nr.782, datë 10.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin e Komisionit Shtetëror, për Organizimin e Veprimtarive Festive “Për vitin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”	9983
Vendim i KM nr.869, datë 14.12.2011	Për përcaktimin e mënyrës, të grupimit dhe të procedurave të likuidimit të detyrimeve të kredimarrësve shtetërorë ndaj Agjencisë së Trajtimit të Kredive.....	9984
Vendim i KM nr.871, datë 14.12.2011	Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DP PPPP).....	9986

Vendim i KM nr.872, datë 14.12.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.....	9988
Vendim i KM nr.873, datë 14.12.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, faza III, në bashkinë e Fierit.....	9990
Vendim i KM nr.874, datë 14.12.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe operimit të autostradës Milot–Morinë.....	9991
Vendim i KM nr.876, datë 14.12.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, dalja Ura e Vashës – Bulqizë.....	9992
Vendim i KM nr.877, datë 14.12.2011	Për një shtesë në vendimin nr.1153, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave publike të shtetit në territorin administrativ të komunës Rrashbull” dhe për një shtesë në vendimin nr.314, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të komunës Rrashbull, të qarkut Durrës”.....	9997
Udhëzim i MASH nr.45, datë 19.12.2011	Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.....	9998
Udhëzim i KMDHP nr.12, datë 21.12.2011	Për kontrollin e identitetit në hyrje të ndërtesave.....	10002
Udhëzim i KMDHP nr.13, datë 22.12.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 5.3.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”.....	10004
Udhëzim i KMDHP nr.14, datë 22.12.2011	Për përpunimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik të publikut.....	10007
Udhëzim i KMDHP nr.15, datë 23.12.2011	Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor.....	10010
Kërkesë e MPPT nr.2367/3, datë 22.12.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor By Pass Plepa-Kavajë-Rrogzhinë (loti 7 rrugët dytësore, tokat)....	10013

VENDIM
Nr.850, datë 14.12.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.23, DATË 12.1.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE TË STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT TË DECENTRALIZUAR TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EUROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARAZGJERIMIT (IPA), KOMPONENTI I, ASISTENCA E TRANZICIONIT DHE FORCIMI INSTITUCIONAL”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 8 të ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit financiar për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.23, datë 12.1.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Nënndarja “iv” e shkronjës “ç” të pikës 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iv) Zyra e KKIPA-së/NIPAC-së, në ministrinë përgjegjëse për integrimin evropian përgatit dhe zbaton manualin e brendshëm të procedurave, i cili miratohet nga KKIPA-ja/NIPAC-ja dhe konfirmohet nga ZKA-ja/NAO-ja;”.

b) Nënndarja “v” e shkronjës “c” të pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“v) Miraton manualin e brendshëm të procedurave për ZKA-në/NAO-në, për Fondin Kombëtar, për Zyrën e NAO-s, dhe për ZAP-në/PAO-në, përgatitur nga këta të fundit.”.

c) Shkronja “b” e pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) ZKA-ja/NAO-ja është autoritet i menaxhimit të decentralizuar, që menaxhon veprimtarinë e Fondit Kombëtar, të cilit i është ngarkuar përgjegjësia për menaxhimin financiar të fondeve të Bashkimit Europian dhe Zyrës së NAO-s, së cilës i është ngarkuar përgjegjësia për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit.”.

ç) Nënndarja “xvi” e shkronjës “c” të pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“xvi) Miraton manualin e brendshme të procedurave për Fondin Kombëtar, Zyrën e NAO-s, ZAP-në/PAO-në dhe Agjencinë Implementuese, si dhe konfirmon manualin e brendshme të procedurave të zyrës së KKIPA-së/NIPAC”.

d) Në fund të shkronjës “c” të pikës 5, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“ZKA-ja/NAO-ja ushtron të gjitha të drejtat si nëpunës i parë autorizues në lidhje me fondet e Bashkimit Europian, në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.10 294, datë 1.7.2010 “Për inspektimin financiar publik”, dhe në përputhje të plotë me nënndarjet 4 e 5 të shkronjës “a” të aneksit A të Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit financiar për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të paraaderimit (IPA).”.

dh) Në fund të pikës 6 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Me kërkesë të ZKA-së/NAO-së, Zyra e ZKA-së/NAO-së kryen kontrole në vend në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve, agjencitë implementuese, si dhe strukturat e IPA-s, në ministrinë e linjës/institucionet përfituese, për kontrollin dhe monitorimin më të frytshëm të projekteve të financuara nën IPA-në, si dhe për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve lidhur me

¹ Shënim. Në përputhje me EU acquis, ID celex-32007R0718, Commission Regulation (EC) No 718/2007 of 12 June 2007 implementing Council Regulation (EC) No 1085/2006 establishing an instrument for pre-accession assistance (IPA)



to, bazuar në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 5 të aneksit A të Marrëveshjes kuadër, në përputhje me pikën 3 të nenit 25 të rregullores IPA 718/2007”.

e) Shkronja “d” e pikës 7 shfuqizohet.

ë) Nënndarjet “i”, “ii” dhe “iii”, të shkronjës “ç” të pikës 11, ndryshojnë, si më poshtë vijon:

“i) Organizon procesin e programimit në përputhje me manualin përkatës të programimit;

ii) Është përgjegjëse për përgatitjen e raporteve vjetore/përfundimtare për zbatimin, organizimin e takimeve të Komitetit të Monitorimit IPA dhe për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dala nga këto takime, si dhe për monitorimin në nivel projekti dhe programi, bazuar në manualin e monitorimit dhe të vlerësimit;

iii) Është përgjegjëse për përgatitjen e planit interim të vlerësimit për programet e komponentit I të IPA-së, si dhe dorëzimin e vlerësimeve interim pranë KKIPA-së/NIPAC-së, të cilin ky i fundit e paraqet në Komitetin e Monitorimit, IPA. Zyra e KKIPA-së /NIPAC-së përgatit termat e referencës për marrjen e vlerësuesve interim dhe shërben si pikë kontakti gjatë vlerësimeve interim.”.

f) Shkronja “d” e pikës 11 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.860, datë 14.12.2011

PËR PRANIMIN E RRRITJES SË KUOTËS SË ANËTARËSIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1, 2 e 3 të ligjit nr.7515, datë 1.10.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet”, të nenit 2 të ligjit nr.10 420, datë 26.5.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për zgjerimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes, si dhe për zgjerimin e Autoritetit Investues të Fondit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të pranojë rritjen e kuotës së anëtarësimi të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar për shumën 11.3 (njëmbëdhjetë pikë tre) milionë SDR, sipas rezolutës nr.63-2, datë 28.4.2008 të Këshillit të Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

2. Autorizohet Banka e Shqipërisë të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e shtesës së kuotës së anëtarësimi në Fondin Monetar Ndërkombëtar, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.861, datë 14.12.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, NDËRMJET PROGRAMEVE, NË BUXHETIN E VITIT
2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

- a) Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” të shtohet fondi 16 700 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekë, për shpenzimet korente.
- b) Në programin “Forcat e luftimit” të shtohet fondi 23 400 000 (njëzet e tre milionë e katërqind mijë) lekë, për shpenzimet korente.
- c) Në programin “Mbështetja e luftimit” të shtohet fondi 88 000 000 (tetëdhjetë e tetë milionë) lekë, për shpenzimet korente.
- ç) Në programin “Mbështetja shëndetësore” të shtohet fondi 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, në (art 602) dhe të pakësohet fondi 25 500 000 (njëzet e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë në (art 606), në shpenzimet korente.
- d) Në programin “Arsimimi ushtarak” të pakësohet fondi 37 600 000 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, në shpenzime korente.
- dh) Në programin “Bashkëpunimi civilo-ushtarak” të pakësohet fondi 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekë, në shpenzimet korente.

2. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.862, datë 19.12.2011

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.782, DATË 10.11.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR, PËR ORGANIZIMIN E
VEPRIMTARIVE FESTIVE “PËR VITIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË
SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës “h” të pikës 2 të vendimit nr.782, datë 10.11.2011 të Këshillit të Ministrave, të shtohet shkronja “i”, me këtë përmbajtje:

“i) Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.869, datë 14.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS, TË GRUPIMIT DHE TË PROCEDURAVE TË
LIKUIDIMIT TË DETYRIMEVE TË KREDIMARRËSVE SHETETËRORË NDAJ
AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22/1 të ligjit nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. GRUPIMI I KREDIMARRËSVE SHETETËRORË, TË TRANSFERUAR NGA BANKAT
TREGTARE TË NIVELIT TË DYTË ME KAPITAL TËRËSISHT SHETETËROR, NË AGJENCINË E
TRAJTIMIT TË KREDIVE**

Kredimarrësit shtetërorë, të transferuar nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, me detyrimet përkatëse në bilancin më të fundit të kësaj Agjencie, të grupohen, si më poshtë vijon:

A. Kredimarrës shtetërorë, persona juridikë publikë, institucione buxhetore dhe jobuxhetore, si:

1. Ministria e Financave (kredi e BKT-së; fondet e veta), me detyrim aktual 161 778 950.58 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë pikë pesëdhjetë e tetë) lekë.

2. Ministria e Brendshme (Rendit) (kredi e BKT-së; kredi austriake), me detyrim aktual 21 698 400.15 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind pikë pesëmbëdhjetë) lekë.

3. Ministria e Ndërtimit dhe Rregullimit të Territorit (kredi e BKT-së; kredi austriake), me detyrim aktual 111 546 025.50 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëzet e pesë pikë pesëdhjetë) lekë.

4. Ministria e Industrisë së Lehtë (Ekonomisë dhe Energjetikës) (kredi e BKT-së; COMAID1+2), me detyrim aktual 211 381 643.20 (dyqind e njëmbëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e tre pikë njëzet) lekë.

5. “MEICO”, Ministria e Mbrojtjes (kredi e BKT-së; fondet e veta), me detyrim aktual 317 746 259.15 (treqind e shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesëmbëdhjetë) lekë.

6. Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Tiranë (kredi e BKT-së; fondet e veta), me detyrim aktual 2 097 535 296.3 (dy miliardë e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tre) lekë.

7. Kombinati i Sheqerit, Maliq (kredi e BKT-së; fondet e veta), me detyrim aktual 89 026 874.00 (tetëdhjetë e nëntë milionë e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave (kredi e BKT-së; kredi italiane), me detyrim aktual 49 090 313.2 (dyzet e nëntë milionë e nëntëdhjetë mijë e treqind e trembëdhjetë pikë dy) lekë.

9. Parku i Udhëtarëve, Tiranë (kredi e BKT-së, Banka Botërore dhe COMAID1+2), me detyrim aktual 396 049 886.53 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e dyzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e tre) lekë.

10. Parku i Udhëtarëve, Durrës (kredi e BKT-së; COMAID 3), me detyrim aktual 26 674 447.80 (njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë tetëdhjetë) lekë.

11. Parku i Udhëtarëve, Vlorë (kredi e BKT-së, Banka Botërore dhe COMAID1+2), me detyrim aktual 124 774 128.49 (njëqind e njëzet e katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e tetë pikë dyzet e nëntë) lekë.

12. Parku i Udhëtarëve, Berat (kredi e BKT-së, Banka Botërore dhe COMAID1+2), me detyrim aktual 52 616 943.09 (pesëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë nëntë) lekë.

13. Parku i Udhëtarëve, Shkodër (kredi e BKT-së, Banka Botërore dhe COMAID1+2), me detyrim aktual 79 689 865.89 (shtatëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e nëntë) lekë.

14. Parku i Udhëtarëve, Poliçan (kredi e BKT-së, Banka Botërore), me detyrim aktual 13 574 715 (trembëdhjetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

15. NFIL-Durrës (kredi e BKT-së; COMAID1+2), me detyrim aktual 20 058 596.34 (njëzet milionë e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tridhjetë e katër) lekë.

16. Albaturizmi, Tiranë (kredi e BKT-së; kredi turke), me detyrim aktual 9 192 285.90 (nëntë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë nëntëdhjetë) lekë.

B. Kredimarrës shtetërorë, të privatizuar, të falimentuar dhe që nuk ekzistojnë:

1. Miniera e Qymyrgurit, Valias (kredi e BKT-së; fondet e veta), me detyrim aktual 29 261 096.3 (njëzet e nëntë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tre) lekë.

2. Agroeksport Tiranë (kredi e BKT-së, kredi turke), me detyrim aktual 287 681 564.10 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë dhjetë) lekë.

II. LEHTËSITË, MËNYRAT DHE PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË DETYRIMIT NË ATK

1. Të fshihen nga bilanci i Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe të kalojnë në pakësim të detyrimeve të saj ndaj Ministrisë së Financave:

a) detyrimet e kredimarrësve shtetërorë, persona juridikë publikë, institucione buxhetore dhe jobuxhetore, të pasqyruar në nënndarjen “A” të kreut I të këtij vendimi, në shumën 3 782 434 631.12 (tre miliardë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një pikë dymbëdhjetë) lekë.

b) detyrimet e kredimarrësve shtetërorë, të privatizuar, të falimentuar dhe që nuk ekzistojnë, të pasqyruar në nënndarjen “B” të kreut I të këtij vendimi, në shumën 316 942 660.4 (treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pikë katër) lekë.

2. Në çdo rast, kredimarrësit shtetërorë duhet të paguajnë shpenzimet gjyqësore e përmbarimore në ATK, si më poshtë vijon:

- “MEICO”, Ministria e Mbrojtjes	1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekë
- Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Tiranë	1 620 800 (një milion e gjashtëqind e njëzet mijë e tetëqind) lekë
- Kombinati i Sheqerit, Maliq	24 800 (njëzet e katër mijë e tetëqind) lekë
- Parku i Udhëtarëve, Tiranë	101 500 (njëqind e një mijë e pesëqind) lekë
- Parku i Udhëtarëve, Berat	24 800 (njëzet e katër mijë e tetëqind) lekë
- Parku i Udhëtarëve, Poliçan	8 000 (tetë mijë) lekë
- Parku i Udhëtarëve, Vlorë	1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.



II. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Agjencia e Trajtimit të Kredive, kredimarrësit shtetërorë të përcaktuar në kreun I të këtij vendimi, si dhe institucionet qendrore apo organet e pushtetit vendor prej nga ato varen, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.871, datë 14.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KONSTATIMIT, TË SHQYRTIMIT, TË PROPOZIMIT DHE TË VENDOSJES SË MASAVE ADMINISTRATIVE NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE (DPPPP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 27 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Konstatimi, shqyrtimi, propozimi dhe vendosja e masave administrative për shkeljet e kryera nga subjektet e ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), sipas kriterëve të mëposhtme:

1. DPPPP-ja kontrollon dhe verifikon përmbushjen e detyrimeve të subjekteve të parashikuara në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, të ndryshuar, nëpërmjet:

- a) inspektimit të tyre;
- b) shqyrtimit të raportimeve, të të dhënave, të dokumenteve apo të raporteve të vetëkontrollit, të dërguara nga subjektet e ligjit nr.9917, datë 19.5.2008, të ndryshuar, dhe/ose të akteve nënligjore;
- c) shqyrtimit të raportimeve të autoriteteve mbikëqyrëse, të dërguara në zbatim të pikës 3 të nenit 24 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Inspektimet realizohen në bazë të planit vjetor të inspektimit, përmbushjes së detyrimeve ligjore, bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse/licencuese. Hartimi i planit vjetor bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Vlerësimin e riskut;
- b) Ecurinë e raportimeve;
- c) Analizat strategjike.

Grupi dhe programi i inspektimit miratohen nga drejtori i përgjithshëm i DPPPP-së.

3. Përfaqësuesit e subjektit, që inspektohet, vënë në dispozicion të grupit të inspektimit çdo regjistër, dokument apo material tjetër që ata gjykojnë të nevojshëm për përmbushjen e qëllimit të inspektimit.

4. Në përfundim të inspektimit përpilohet akti i inspektimit, i cili mbahet në vendin e kryerjes së tij, në prani të përfaqësuesit të subjektit dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit dhe përfaqësuesit e subjektit. Në rastet kur kundërvajtësi kundërshton nënshkrimin, ky fakt evidentohet në aktin e inspektimit. Akti i inspektimit përmban të dhënat për subjektin e inspektuar, konkluzionet përkatëse,

9986

llojin e kundërvajtjes së konstatuar dhe rekomandimet që i lihen subjektit të inspektuar. DPPP-jë njofton zyrtarisht subjektin për shkeljen e konstatuar.

5. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative si rregull bëhet në prani të përfaqësuesit të subjektit, i cili njoftohet nga DPPP-jë për datën dhe orën e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative. Subjekti në seancën e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative ka të drejtë të paraqesë çdo pretendim në lidhje me shkeljet e konstatuara. Shqyrtimi mund të bëhet edhe në mungesë, kur vërtetohet se kundërvajtësi ka marrë dijeni dhe nuk ka shkaqe të arsyeshme për mosparaqitje.

6. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e konstatimit të saj. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, të parashikuara në nenin 27 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, të ndryshuar, nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 2 (dy) vjet nga koha e kryerjes së kundërvajtjes administrative.

7. Kundërvajtja shqyrtohet nga komisioni i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, i ngritur me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të DPPP-së. Komisioni, pasi njihet me shkeljet e konstatuara dhe pasi dëgjon argumentet dhe administron dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, i propozon drejtorit të Përgjithshëm:

a) vendosjen e masës së gjobës për kundërvajtjen administrative;
b) pushimin e procedimit të kundërvajtjes administrative, kur nga analizimi dhe shqyrtimi i fakteve nuk konstatohet kryerja e kundërvajtjes administrative.

8. Drejtori i Përgjithshëm, pasi vlerëson dhe analizon praktikën e inspektimit dhe propozimin e komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, merr vendim për vendosjen e masës administrative ndaj subjektit ose pushimin e procedimit të kundërvajtjes administrative dhe njofton zyrtarisht subjektin.

9. Vendimi për kundërvajtjen administrative, përveç të dhënave të institucionit që ka nxjerrë aktin, duhet të ketë identitetin e kundërvajtësit, shpjegimin e përmbledhur të fakteve dhe provave ku mbështetet vendimi, shkeljen e tyre duke referuar dispozitën ligjore ku mbështetet vendimi, masat administrative të dënimit me gjobë, dokumentacionin që tregon shkeljen e kryer, cilësimin si titull ekzekutiv për masën e gjobës, si dhe të drejtat për ankimimin dhe afatet procedurale.

10. Në përzgjedhjen e llojit të dënimit dhe caktimin e masës së tij, DPPP-jë duhet të marrë parasysh:

- a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
- b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
- c) rëndësinë e kundërvajtjes;
- ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi dhe mosveprimi.

11. Vendimi për kundërvajtjen administrative, i vendosur nga DPPP-jë, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i këtij vendimi bëhet në përputhje me ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

12. Për njoftimin dhe afatet e njoftimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative, të nxjerra nga DPPP-jë, zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

13. Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë nga DPPP-jë, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

II. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP), si autoritet përgjegjës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.872, datë 14.12.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese e institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, pas fjalëve “... Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ...” të shtohen fjalët “... Gjykatën e Lartë ...”.

2. Në fund të pikës 1/1 të shtohen emërtesat “Gjykata e Lartë” dhe “Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

3. Në shkronjën “a” të pikës 1/3, të shtohet emërtesa “Qendra Kombëtare e Licencimit” dhe të shfuqizohet emërtesa “Qendra Kombëtare për Aplikimet Energjetike”.

4. Në shkronjën “b” të pikës 1/3, të shtohen emërtesat “Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” dhe “Agjencia e Shërbimit Arkeologjik”.

5. Paragrafi i parafundit i pikës 4/1, të riformulohet, si më poshtë vijon:

“Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës. Në rast se, për institucionet, ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërcituara në këtë vendim, parashikohen shtesa të tjera për kushte pune, këta nëpunës do të zgjedhin ndërmjet dy shtesave, por, në asnjë rast, nuk mund t’i përfitojnë të dyja shtesat.”.

6. Pika 4/5 riformulohet, si më poshtë vijon:

“4/5. Në Komisionin e Prokurimit Publik, kryetari i Komisionit, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa zëvendëskryetari, anëtarët dhe nëpunësit në drejtoritë apo sektorët teknikë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.”.

7. Pikat 4/8 dhe 4/11 shfuqizohen.

8. Pikat 4/9, 4/10, 4/12 dhe 4/13 rinumërohen, përkatësisht, 4/8, 4/9, 4/10 dhe 4/11.

9. Në fund të grupit të përfituesve të dëshmërisë së shëndetit, të përcaktuar në pikën 5, të shtohet emërtesa “Sanitar në sistemin doganor”.

10. Në pikën 10/8 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit/punonjësit e kategorizuar në kategoritë C3, D1, D2 dhe D3, të lidhjes nr.6/8, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë, në masën 1% mbi pagën e pozicionit pas çdo viti pune, deri në 25 vjet.”.

11. Lidhja nr.7, që përmendet në pikën 11, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2011, për:

- Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, të përballohen nga fondet e parashikuara për këtë institucion, për vitin 2011, dhe të fillojnë nga data e emërimit në punë të nëpunësve/punonjësve.

- Për të gjitha parashikimet e tjera, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, të planifikuara për vitin 2011, dhe të fillojnë nga data 15 korrik 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.7

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në institucionet qendrore të përcaktuara sipas pikës 1/3/b të këtij vendimi

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës, paga e grupit
Titullar i institucionit Drejtor Ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit Kancelar në universitet	II-b	1
Zv/titullar i institucionit Drejtor drejtorie Ekspert mjeko-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Inspektor në administratën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit Administrator në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara Inspektor në Organin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil	III-a	1
Drejtor Drejtorie Kryeredaktor në Qendrën e Publikimeve Zyrtare Përgjegjës sektori Ekspert toksikologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Ekspert psikiatër-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Ekspert biologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Ekspert mjeko-ligjor pranë gjykatave të apelit Drejtor i Bibliotekës Shkencore të universiteteve Kancelar në fakultet	III-a/1	1
Përgjegjës sektori Kryetar dege në rektorat	III-b	1
Redaktor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Inspektor	III-b	1 ose 2
Kryetar dege në fakultet Përgjegjës biblioteke në universitete dhe shkollat e tjera të larta Përgjegjës sektori në rektorat Përgjegjës sektori në Bibliotekën Shkencore të Universitetit Kryesekretar në universitete dhe shkollat e tjera të larta dhe Shkollën e Magjistraturës	IV-a	1
Specialist në administratën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit Sekretar i kualifikimit shkencor në Shkollën e Magjistraturës	IV-a	1 ose 2 ose 3



Klasifikator dhe kryebibliotekar në universitete dhe shkollat e tjera të larta Bibliograf në universitete dhe shkollat e tjera të larta dhe Shkollën e Magjistraturës		
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3
Informaticien në Qendrën e Publikimeve Zyrtare	IV-b	1 ose 2 ose 3
Informaticien në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit		
Korrektor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare		
Kurator		
Inspektor		
Bibliograf		
Klasifikator		
Bibliotekar		
Restaurator		
Lektor		
Administrator		
Redaktor		
Studiues		
Mjek në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor		
Bibliotekar në Bibliotekën Shkencore të Universitetit	IV-b	1 ose 2 ose 3
Bibliotekar në bibliotekën e fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes		
Laborant me arsim të lartë në universitete dhe shkollat e tjera të larta		
Sekretar mësimor		
Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit		
Mjek në Qendrën Kulturore të Ushtrisë		

VENDIM

Nr.873, datë 14.12.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, FAZA III, NË BASHKINË E FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, faza III, në bashkinë e Fierit.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, për sipërfaqen prej 5000 (pesë mijë) m² tokë arë, pronë private, paraqiten sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të cilët shpronësohen, është 5 000 000 (pesë milionë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Fierit, planifikuar në buxhetin e saj.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Fierit.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Fierit, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Fierit. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 5 000 (pesë mijë) m² tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Fierit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Fierit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE FAZA III”,
NË BASHKINË E FIERIT**

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. arë m²	Çmimi lekë/ m²	Vlera lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale
1	Agim Qazim Hoxhaj	3361	1000	3361000	288/102	2637
2	Iliaz Qazim Hoxhaj	1639	1000	1639000	288/37	2637
	Totali	5000		5 000 000		

VENDIM
Nr.874, datë 14.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES, REHABILITIMIT DHE OPERIMIT TË
AUTOSTRADËS MILOT-MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1 dhe 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të shërbimit të mirëmbajtjes dhe operimit të autostradës Milot-Morinë është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Koncesioni do të jetë i formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi).

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.876, datë 14.12.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR, DALJA URA E VASHËS - BULQIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, dalja Ura e Vashës-Bulqizë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 100 487 (njëqind mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) m², tokë arë, me vlerë 19 205 301 (nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e pesë mijë e treqind e një) lekë, për sipërfaqen 1 733 (një mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) m², tokë truall, me vlerë 1 123 213 (një milion e njëqind e njëzet e tre mijë e dyqind e trembëdhjetë) lekë, për objekte, me vlerë 9 501 938 (nëntë milionë e pesëqind e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekë, si dhe për kultura bujqësore, me vlerë 527 061 (pesëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 30 357 513 (tridhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 166 000 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 30 357 513 (tridhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2011, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Shpronësimi të përfundojë më 30.12.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë të rifreskuar brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikës 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Mat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Rrugëve, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Mat, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Mat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“DALJE URA E VASHËS – BULQIZË

Qarku Dibër, bashkia: Bulqizë, fshati Vajkal 1

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemeri	Zona kad.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë								Shënime
						Arë	Çmimi	Vlera	Truall	Çmimi	Vlera	Objekte	Kult. Bujq.	
						m ²	Lekë	(Lekë)	m ²	Lekë	(Lekë)	V.(Lekë)	V.(Lekë)	
1	Shefqet	Bajram	Koçi	3694	629	25	197	4925						4925 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Sulejman	Lahim	Koçi	3694	628	161	197	31717						31717 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Kamber	Lahim	Koçi	3694	627	270	197	53190						53190 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Lahim	Sulejman	Koçi	3694	626	322	197	63434						63434 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Lahim	Sulejman	Koçi	3694	625	347	197	68359						68359 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Lahim	Sulejman	Koçi	3694	624	475	197	93575						93575 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Sabri	Shahin	Koçi	3694	622	1464	197	288408						288408 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Sabri	Shahin	Koçi	3694	619	120	197	23640						23640 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Sahate	Ali	Koçi	3694	598	696	197	137112						137112 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Figiri	Ferit	Gjoka	3694	599	894	197	176118						176118 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Figiri	Ferit	Gjoka	3694	600	566	197	111502						111502 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Festim	Ferit	Gjoka	3694	601	695	197	136915						136915 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Dilaver	Sali	Koçi	3694	597	16	197	3152						3152 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	(B.Pron.) Skender Xhelal	Begu		3694	516	1721	197	339037						339037 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Ismail	Mehmet	Hida	3694	602	652	197	128444						128444 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Seit	Mehmet	Hida	3694	611	641	197	126277						126277 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	Mustafa	Bajram	Keta	3694	511	11	197	2167						2167 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	Lutfi	Nezir	Keta	3694	514	16	197	3152						3152 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	Fatime	Sulejman	Keta	3694	512	325	197	64025						64025 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	Shefqet	Jonuz	Keta	3694	515	614	197	120958						120958 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	Ibrahim, Ahmet , Muharrem Mira		Latif Mira	3694	605	1943	197	382771						382771 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
22	Qamil	Hysen	Gjini	3694	1867	178	197	35066					58910	93976 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	Shpresa	Rakip	Llorja	3694	1915	300	197	59100						59100 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24	Ferit	Hysen	Gjini	3694	1868	239	197	47083					28160	75243 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	Isuf	Rexhep	Llorja	3694	1871	321	197	63237					86600	149837 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	Ilmi	Isuf	Llorja	3694	1914	198	197	39006						39006 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	Ismahil	Mehmet	Hida	3694	1874	722	197	142234						142234 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	Selvie	Muharrem	Deda	3694	1909	297	197	58509						58509 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
29	Sahit	Mehmet	Hida	3694	1875	492	197	96924						96924 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	Sali	Hysen	Keta	3694	1908	628	197	123716						123716 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	Sali	Hysen	Keta	3694	1907	669	197	131793						131793 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	(B.P.) Shyqyri, Luzim, Ferit, BALA		Shefqet Bala	3694	1906	289	197	56933						56933 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	MUHARREM	Mexhit	Bala	3694	1905	327	197	64419					64500	128919 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	(B.Pr.) Peme Boduri, Ali Ferit	Basha		3694	1886	1138	197	224186					19325	243511 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	Skender	Ali	Rahmani	3694	1885	796	197	156812						156812 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	Sami	Muharrem	Çupi	3694	2315	503	197	99091						99091 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	Skender	Ali	Rahmani	3694	2313	677	197	133369						133369 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
38	Mehmet	Myslym	Shehu	3694	2311	744	197	146568						146568 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
39	Sahit	Liman	Lamani	3694	2577	2529	197	498213						498213 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	Muharrem	Hajdar	Stafa	3694	2305	788	197	155236						155236 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	Tahir	Hajdar	Stafa	3694	2317	3116	197	613852						613852 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	Skender	Ali	Rahmani	3694	2318	3199	197	630203						630203 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
43	Rrushe	Elmaz	Rahmani	3694	2319	2291	197	451327						451327 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
44	Tice	Muharrem	Gjoka	3694	2332	2279	197	448963						448963 Konfirmuar nga ZVRPP-ja



Fletorja Zyrtare
e Republikës së Shqipërisë

45	Mine	Xhemal	Gjoka	3694	2333	535	197	105395						105395	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
46	Agim	Ismail	Gjoka	3694	2334	663	197	130611						130611	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
47	Haki	Ramiz	Gjoka	3694	2335	270	197	53190						53190	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
48	(B.Pr.) Fatmir, Adem Qazim		Gjoka	3694	2336	375	197	73875						73875	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
49	Haxhi	Abedin	Gjoka	3694	2338	376	197	74072						74072	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
50	Sami	Muharrem	Çupi	3694	2341/3	280	197	55160						55160	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
51	Muharrem	Dalip	Çupi	3694	2341/4	280	197	55160						55160	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	Figjiri	Hamit	Boduri	3694	2310	3829	197	754313						754313	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
53	Sherife	Bajram	Seiti	3694	2309	6313	197	1243661	212	728	154336	2559150	187100	4144247	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
54	Halit	Liman	Lamani	3694	2307	4130	197	813610						813610	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
55	Urim	Tahir	Stafa	3694	2306	42	197	8274						8274	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
56	Tonin	Rakip	Lamani	3694	2308	651	197	128247						128247	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
57	Zenel	Hysen	Rahmani	3694	2330	3240	197	638280						638280	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
58	(B.Pr.) Rakip Hazis		Lamani	3694	2692	1890	197	372330						372330	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
59	Luan	Liman	Pepa	3694	1978	650	197	128050						128050	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
60	Muharrem	Hajdar	Stafa	3694	2578	1386	197	273042						273042	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
61	Zenel	Hysen	Rahmani	3694	2693	69	197	13593						13593	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
62	Skender	Ali	Rahmani	3694	2695	154	197	30338						30338	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
63	Rrushe	Elmaz	Rahmani	3694	2694	64	197	12608						12608	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
64	Tahir	Hajdar	Stafa	3694	2579	126	197	24822						24822	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
65	Skender	Ali	Rahmani	3694	2580	223	197	43931						43931	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
66	Skender	Ali	Rahmani	3694	2559	849	197	167253						167253	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
67	Islam	Sul	Lamani	3694	2565	151	197	29747						29747	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
68	Islam	Sul	Lamani	3694	2558	4705	197	926885						926885	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
69	Shefqet	Jonuz	Keta	3694	2555	621	197	122337						122337	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
70	Gezim	Sadik	Keta	3694	2556/2	406	197	79982						79982	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
71	Lutfi	Nezir	Keta	3694	2556/1	129	197	25413						25413	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
72	Vehbi	Bajram	Keta	3694	2554	649	197	127853						127853	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
73	(B.Pr.) Zaim, Kujtim, Selim		Gjoka	3694	2339	638	197	125686						125686	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
74	(B.Pr.) Zaim, Kujtim, Selim		Gjoka	3694	2340	424	197	83528						83528	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
75	(B.Pr.) Aslan Ismail		Çupi	3694	2342	243	197	47871						47871	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
76	Bukurie	Shefqet	Çupi	3694	2343	226	197	44522						44522	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
77	Shahin	Mustafa	Gjoka	3694	2344	367	197	72299						72299	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
78	Agim	Ramiz	Lamani	3694	2346	435	197	85695						85695	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
79	Agim	Ramiz	Lamani	3694	2350	377	197	74269						74269	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
80	Islam	Sul	Lamani	3694	2352	134	197	26398						26398	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
81	Tonin	Rakip	Lamani	3694	2353	103	197	20291						20291	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
82	Halit	Liman	Lamani	3694	2354	103	197	20291						20291	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
83	Hajdar	Feta	Çupi	3694	2355	122	197	24034						24034	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
84	Latif	Feta	Çupi	3694	2356	95	197	18715						18715	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
85	Gjyl	Feta	Çupi	3694	2357	134	197	26398						26398	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
86	Lime	Ahmet	Çupi	3694	2358	367	197	72299						72299	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
87	Muharrem	Qazim	Çupi	3694	2359/1	325	197	64025						64025	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
88	Gjynrie	Isuf	Çupi	3694	2371/2	341	197	67177						67177	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
89	Ibrahim	Mustafa	Çupi	3694	2371/1	476	197	93772						93772	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
90	(B.Pr.) Hasan	Rushit	Çupi	3694	2378	1872	197	368784						368784	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
91	MUSTAFA	Ibrahim	Çupi	3694	2384	1528	197	301016						301016	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
92	(B.Pr.) Qamil I. Bala dhe Ismail Q.		Bala	3694	1882	532	197	104804						104804	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
93	(B.Pr.) Hasan Rushit		Çupi	3694	2385	1303	197	256691						256691	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI (Iekë)					77895		15345315	212		154336	2559150	444595	18503396	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“DALJE URA E VASHËS – BULQIZË”**

Qarku Dibër, bashkia: Klos, fshati Plan i Bardhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemeri	Zona kad.	Nr. i pasur	Arë m²	Lloji i pasurisë								Shënime	
							Çmimi	Vlera		Truall	Çmimi	Vlera	Objekte	Kult. Bujq.		Shuma
							Lekë	(Lekë)		m²	Lekë	(Lekë)	V(Lekë)	V(Lekë)		(lekë)
1	Hysen	Selman	Losha	2982	181/3	129	155	19995						19995	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
2	Astrit	Xhemal	Allushi	2982	181/1	556	155	86180						86180	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
3	Bashkim		Beta	2982	171/11	532	155	82460						82460	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
4	Zenel		Sallaku	2982	152/3				216	637	137592			137592	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
5	Sadik		Alla	2982	153/1	248	155	38440						38440	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
6	Demir	Ahmet	Sallaku	2982	134/5	623	155	96565						96565	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
7	Qemal	Hysen	Basha	2982	82/3	732	155	113460						113460	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
8	Sadik dhe Xhavit	Liman	Beta	2982	84/8	29	155	4495						4495	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
9	Afrim		Bushi	2982	84/7	106	155	16430						16430	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
10	Sami	Ramazan	Basha	2982	81/4	75	155	11625						11625	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
11	Sami	Ramazan	Basha	2982	80/1	2276	155	352780						352780	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
12	Peme	Idriz	Suldisha	2982	73/5				78	637	49686	1836806	23554	1910046	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
13	Bajram		Suldisha	2982	73/6	276	155	42780						42780	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
14	Çire	Hasan	Suldisha	2982	73/1	287	155	44485	151	637	96187	1653435	58912	1853019	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
15	Çire	Hasan	Suldisha	2982	74/4	61	155	9455						9455	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
16	Besim	Ali	Jaurri	2982	30/2	696	155	107880	300	637	191100			298980	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
17	Tofik		Kuqali	2982	33/1	1701	155	263655						263655	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
18	Gezim		Sallaku	2982	165/6	19	155	2945						2945	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
19	Gezim		Sallaku	2982	135/2	222	155	34410						34410	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
20	Bajram		Hasula	2982	135/1	471	155	73005						73005	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
21	Rahman	Rexhep	Beta	2982	124/2	83	155	12865	300	637	191100			203965	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
22	Ruzhdi	Bajram	Beta	2982	124/1	947	155	146785	300	637	191100			337885	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
23	Mehmet	Ferit	Basha	2982	82/4	420	155	65100						65100	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
24	Kujtim	Ferit	Basha	2982	82/1	506	155	78430						78430	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
25	Tofik		Kuqali	2982	30/1	836	155	129580						129580	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
26	Qazim	Ali	Jaurri	2982	31/1	1334	155	206770						206770	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
27	Gani		Suldisha	2982	73/7				176	637	112112	2428163		2540275	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
28	Kadri		Likmeta	2982	26/10							1024384		1024384	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	
	TOTALI (lekë)					13165		2040575	1521		968877	6942788	82466	10034706		



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“DALJE URA E VASHËS BULQIZË” Qarku Dibër

Bashkia: Bulqizë, fshati Vajkal 2

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemeri	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë			Shënime
						Arë	Çmimi	Vlera	
						m ²	lekë	(lekë)	
1	Mexhit	Hasan	Voci	3694	752/2	212	193	40916	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Pëllumb	Mexhit	Voci	3694	752/1	290	193	55970	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Shkelqim	Ibrahim	Çupi	3694	751	748	193	144364	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Nele	Muharrem	Dauti	3694	696	826	193	159418	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Fiqe	Xhelal	Dauti	3694	695/2	421	193	81253	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Farie	Elmaz	Dauti	3694	695/1	375	193	72375	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Hasan	Sulejman	Dauti	3694	692	269	193	51917	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Hasan	Sulejman	Dauti	3694	691	344	193	66392	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Mite	Ibrahim	Dauti	3694	688	179	193	34547	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Luan	Medi	Dauti	3694	687	340	193	65620	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Haki	Isuf	Dauti	3694	686	403	193	77779	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Xhevahir	Haxhi	Nasufi	3694	1810/1	1234	193	238162	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Farie	Elmaz	Dauti	3694	1812/1	1301	193	251093	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	Fiqe	Xhelal	Dauti	3694	1812/2	391	193	75463	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Fiqe	Xhelal	Dauti	3694	2821	955	193	184315	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	(B.Pr.) Mehmet,	Qemal,Zemrie	Dauti	3694	1813	1139	193	219827	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		TOTALI	(lekë)			9427		1819411	

VENDIM
Nr.877, datë 14.12.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1153, DATË 13.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE PUBLIKE TË SHTETIT NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË KOMUNËS RRASHBULL” DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.314, DATË 12.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PYJEVE DHE KULLOTAVE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS RRASHBULL, TË QARKUT DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1153, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Rrashbull, të qarkut të Durrësit, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 1 (një).

2. Në vendimin nr.314, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e inventarit përfundimtar të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Rrashbull, të qarkut të Durrësit, me 1 (një) fletë, e cila përfundon me numrin rendor 2 (dy).

3. Listat me shtesat për inventarin dhe transferimin dhe lidhja me numrin 1 (një), i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrashbull, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Rrashbull, qarku Durrës

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
62, 162	Sipërfaqe me bimësi pyjore, pyll mbrojtës	Pronësi



2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)
Për një shtesë në listën përfundimtare të transferimit të pyjeve dhe kullotave, miratuar me vendim të
Këshillit të Ministrave me nr.314, datë 12.3.2008

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Tiranë										
Komuna Rrashbull										
Fusha e përdorimit të pronës: pyje										
Nr. Rend.	Nr. i pasurisë Sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sip. në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Instituti enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
1	162	Shijak-Maminas	Memje	16	Boshe	2.25		MMPAU	DSHP Durrës	
2	62	Shijak-Maminas	Bozabxhie	26a	Trungishte	4.25	Mbrojtës + prodhues	MMPAU	DSHP Durrës	
						6.5				

- Duke qenë se kjo n/ngastër pyjore 26a është e vetme dhe në distancë të largët nga ngastrat e tjera, por në kufi me n/ngastrën 26b sipërfaqe boshe që ka kaluar në pronësi të komunës Rrashbull me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.314, datë 12.3.2008, DSHP-ja Durrës ia propozon për transferim komunës Rrashbull.

- Sipërfaqja prej 4.25 ha i përket ngastrës pyjore nr.26a të ekonomisë pyjore Shijak-Maminas dhe nuk është përfshirë në listën e Monumenteve të Natyrës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.676, datë 20.12.2002.

UDHËZIM
Nr.45, datë 19.12.2011

PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 58 pika 3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Çdo student në momentin e pranimit duhet të regjistrohet në regjistrin bazë të studentëve. Çdo studenti, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë (IAL), i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës.

2. Studentët e marrin numrin e matrikullimit (NIM) të përbërë nga gjashtë germa dhe dy shifra të kodit të regjistrimit dhe katër shifrat e numrit të studentit në regjistrin përkatës. Formimi i numrit të matrikullimit është sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Në rast se një student largohet ose transferohet nga një fakultet pa e përfunduar kursin e studimit, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër.

4. Regjistrat e studentëve për një vit akademik, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, të organizohen në bazë njësie kryesore (fakulteti), cikli studimi dhe formë studimi.

5. Çdo regjistër të ketë një kod të vetin, unikal në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i përbërë nga gjashtë germa dhe dy shifra. Germa e gjashtë e kodit të regjistrimit përcaktohet në bazë të ciklit të studimit dhe formës së studimit, sipas shtojcës nr.2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Kodet e regjistrave në përdorim për çdo institucion të arsimit të lartë, përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP).

7. Për hapjen e një regjistri IAL, duhet të aplikojë në AKP për të marrë kodin e regjistrimit përkatës.

8. Brenda një fakulteti regjistrat bazë të studentëve të organizohen më vete për çdo formë studimi (sistemi me kohë të plotë, kohë të pjesshme, edukim në distancë, etj.) dhe për secilin cikël studimi (cikli I, cikli II dhe cikli III).

9. Institucionet e arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), listën e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2011-2012 e në vazhdim, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD), në format EXCEL, sipas shtojcës nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet. IAL-të të dërgojnë të dhënat në AKP, sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet.

10. AKP brenda 1 muaji i dërgon institucioneve të arsimit të lartë, listën përkatëse të numrave të matrikullimit për çdo student.

11. AKP përgatit rregulloren teknike të administrimit dhe sigurisë së bazës shtetërore (kombëtare) të të dhënave të studentëve.

12. Udhëzimi nr.19, datë 18.7.2007 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Shtojca nr.1

a) Formimi i numrit të matrikullimit

U	T	F	S	N	A	0	1	0	0	0	1
---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Universiteti

Fakulteti			Tip.Regj.Programi				Nr. i amzës				
-----------	--	--	-------------------	--	--	--	-------------	--	--	--	--

Kodi i IAL përbëhet nga dy germa, të cilat vendosen në mënyrë unike.

Kodi i fakultetit përbëhet nga pesë germa, ku dy të parat përbëjnë kodin e IAL-së përkatëse.

Tipi i regjistrimit do të varet nga cikli dhe forma e studimit. Ai do të jetë i njësuar për të gjitha IAL-të: një cikël studimi + një formë studimi do të përdoret të njëjtën gërmë.

Programi i studimit përbëhet nga dy shifrat e para, të cilat vendosen në mënyrë unike, gjashtë gërmat dhe dy shifrat e para përbëjnë kodin e regjistrimit dhe përcaktohen nga AKP.



Shtojca nr.2: Përcaktimi i numrit të llojit të regjistrit

Germa, regjistri	Regjistri tip, përshkrimi
A	Bachelor-KP (cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë)
B	Msc-KP (cikli i dytë i studimeve, Master i shkencave/Master i arteve të bukura, me kohë të plotë)
C	Bachelor-PT (cikli i parë i studimeve, me kohë të pjesshme)
D	Msc-PT (cikli i dytë i studimeve, Master i shkencave/Master i arteve të bukura, me kohë të pjesshme)
E	Msc-KP (Cikël unik 5-vjeçar, me kohë të plotë)
F	Msc-PT (Cikël unik 5-vjeçar, me kohë të pjesshme)
G	MP-KP (Cikli i dytë i studimeve, Master profesional, me kohë të plotë)
H	MP-KP (Cikli i dytë i studimeve, Master profesional, me kohë të pjesshme)
K	SPM-KP (Specializim post Master, me kohë të plotë)
L	SPM-PT (Specializim post Master, me kohë të pjesshme)
M	SPECIALIZIM AFATGJATË
N	DOKTORATË
P	Bachelor-DIST (Cikli i parë i studimeve në distancë)
Q	DP-KP (Program studimi jo universitar Profesional-ish SLU, me kohë të plotë)
R	DP-PT (Program studimi jo universitar Profesional-ish SLU, me kohë të pjesshme)
X	Regjistër i mbyllur
Y	Regjistër i mbyllur
Z	Regjistër i mbyllur

Tabela nr.3: Pasqyra e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2011-2012
Emërtimi sipas ciklit dhe formës së studimit (sipas shtojcës nr.2)

Nr.	Universiteti	Fakulteti	Cikli i studimit	Programi i studimit	Data e regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Rrethi nga vjen	Numri i dokumentit të identifikimit	Lloji i dokumentit të identifikimit	Shkolla e mesme	ID e maturës
1															
2															
3															
4															
5															
6															
7															
8															
9															
10															
11															
12															
13															
14															
15															
16															
17															
18															
19															
20															
21															
22															
23															
24															
25															



UDHËZIM
Nr.12, datë 21.12.2011

PËR KONTROLLIN E IDENTITETIT NË HYRJE TË NDËRTESAVE

Mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

KREU I
OBJEKTI

1. Ky udhëzim rregullon disa të drejta dhe detyrime të pronarëve të ndërtesave apo administratorëve (më poshtë referuar si “Kontrollues”) në kuadrin e kontrolluesve të identitetit në hyrje të një ndërtese apo zone.

KREU II
PËRKUFIZIME

1. “Kontrolli i identitetit” në hyrje të ndërtesave, është një lloj i veçantë përpunimi i të dhënave personale. Arsyeja kryesore e këtij procesi është të zbulojë dhe verifikojë identitetin e individit.

2. “Mjet identifikimi” është çdo lloj dokumenti zyrtar që vërteton identitetin e mbajtësit me anë të elementeve identifikues të tilla si emri dhe mbiemri i personit dhe që ka të paktën një fotografi.

3. “Zonat e kufizuara apo ndërtesat me akses të kufizuar” (më poshtë referuar “ndërtesa me akses të kufizuar”) nënkuptojnë çdo ndërtesë apo zonë që nuk është e hapur për publikun.

4. “Të dhënat personale bazë” janë të dhënat që zbulojnë emrin, mbiemrin, numrin dhe llojin e mjetit të identifikimit të vizitorit dhe arsyeja e hyrjes në ndërtesë.

5. “Pronari ose administratori” është një person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci, etj. Mund të ndodhë që administratori dhe pronari të jenë i njëjti person, ose që administratori të jetë autorizuar nga pronari ose nga ligji për të kryer kontrollin e identitetit në hyrje të një ndërtese apo zone.

KREU III
DISPOZITA HYRËSE

1. Të dhënat personale në kontekstin e kontrolluesve të identitetit në hyrje të një ndërtese përpunohen duke respektuar ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

2. Pronari ose administratori në kuptim të këtij udhëzimi është në pozicionin e kontrolluesit, nëse mbledh të dhëna për kontrollin e identitetit në hyrje të një ndërtese apo zone. Ai mund të kryejë kontrollin e identitetit në hyrje të një ndërtese apo zone vetë, me anë të punonjësve të tij ose mund të kontrakttojë një përpunues, punonjës i një shoqërie të ruajtjes dhe sigurisë fizike për përpunimin e të dhënave personale.

3. Kontrolluesi nënshkruan një kontratë me shkrim me përpunuesin, duke përcaktuar në të detyrimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 20 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Dispozitat e këtij udhëzimi nuk do të cenojnë detyrimet e kontrolluesit për përpunimin e të dhënave personale sipas një legjislacioni tjetër përkatës të zbatueshëm.

KREU IV PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Nëse një ndërtesë ose një zonë është e hapur për publikun, mbledhja e të dhënave të vizitorëve është e ndaluar.
2. Nëse një ndërtesë është me hyrje të kufizuar, kontrolluesi ose përpunuesi ka të drejtë të kërkojë dhënien e të dhënave personale bazë nga vizitorët.
3. Të dhënat personale bazë dhe koha e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa mund të regjistrohen dhe përpunohen për qëllimin e vetëm të mbrojtjes së:
 - a) pronës; ose
 - b) drejtimit dhe sigurisë së një ndërtese.
4. Kontrolluesi dhe përpunuesi nuk do të përhapin të dhënat personale, veçanërisht duke i ndarë ose duke i vënë në dispozicion të çdo pale të tretë, nëse ky qëllim nuk është i lidhur me qëllimet e mbrojtjes së pronës ose drejtimit dhe sigurisë së ndërtesës, pa pëlqimin e shprehur qartë të vizitorit, ose përveç kur në një dispozitë të një akti të veçantë parashikohet ndryshe.
5. Gjatë mbledhjes së të dhënave personale, kontrolluesi është i detyruar të informojë vizitorin, veçanërisht në lidhje me:
 - a) sferën dhe qëllimin për të cilin të dhënat personale do të përpunohen;
 - b) nga kush dhe në çfarë mënyre do të përpunohen të dhënat personale;
 - c) kujt do mund t'i përhapen të dhënat personale;
 - d) pasojat e refuzimit të dhënies së të dhënave personale.
6. Të dhënat personale do të fshihen menjëherë pasi të mos jenë më të nevojshme për qëllimet e mbrojtjes së pronës ose drejtimit dhe sigurisë së ndërtesës me hyrje të kufizuar. Nevoja për të vazhduar ruajtjen e të dhënave personale, do të rivlerësohet çdo 14 ditë.
7. Pronari ose administratori do të njoftojë Komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale për çdo përpunimin të të dhënave personale për qëllime të mbrojtjes së pronës ose të administrimit të ndërtesës dhe të sigurisë.

KREU V MJETI I IDENTIFIKIMIT

1. Vizitorët duhet të paraqesin një mjet identifikimi të tyre të përshtatshëm kur hyjnë në ndërtesë me hyrje të kufizuar.
2. Kopjimi i mjetit të identifikimit dhe mbledhja e këtyre kopjeve për kontrollet e identitetit në hyrje të ndërtesës janë të ndaluara.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

1. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.
 2. Për zbatimin e këtij udhëzimi detyrohen të gjitha subjektet e parashikuara në pikën 5 të kreut II të këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)



UDHËZIM
Nr.13, datë 22.12.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 5.3.2010 “MBI SISTEMIN E VIDEO SURVEJIMIT NË NDËRTESA, LOKALE E AMBIENTE TË NDRYSHME”

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.3, datë 5.3.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Titulli i udhëzimit nr.3, datë 5.3.2010 ndryshohet si vijon:

“Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja e parë ndryshohet si vijon:

“Të dhënat e ruajtura në sistemin e video survejimit, imazhe apo tinguj, janë të dhëna personale me kusht që një individ të mund të identifikohet drejtpërdrejt apo tërthorazi në bazë të këtyre regjistrimeve.”

b) Fjalja e dytë ndryshohet si vijon:

“Një individ është i identifikueshëm, nëse imazhi në të cilën ai është regjistruar zbulon shenjat e tij dalluese si fytyrën, etj., dhe mundëson identifikimin e plotë të tij kur këto karakteristika krahasohen me të dhëna të tjera në dispozicion.”

3. Në pikën 3 shprehja “sistemi të kamerave regjistruese të video survejimit” ndryshohet në “sistemi video survejimi”.

4. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

Shprehja “sistem të kamerave regjistruese të video survejimit” ndryshohet në “sistem të video survejimit”.

a) Shkronja “a” ndryshohet si vijon:

“Sistemi i video survejimit nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve. Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Instalimi i një sistemi video survejimi është i ndaluar në dhoma që përdoren ekskluzivisht për qëllime private si tualete, dushe, zhveshje.”

b) Shkronja “b” ndryshohet si vijon:

“Qëllimi i regjistrimit duhet të specifikohet qartë dhe të jetë në përputhje me interesat ligjorë të kontrolluesit. Regjistrimet mund të përdoren vetëm për hetimin e një ngjarjeje që ka sjellë dëmtimin e këtyre interesave të mbrojtur me ligj. Legjitimiteti i përdorimit të të dhënave personale të regjistruara për qëllime të tjera duhet të jetë i kufizuar vetëm për një interes të rëndësishëm publik.”

c) Shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“Periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video survejimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video survejimit do të ruhen për një periudhë deri në dy muaj dhe pas kalimit të kësaj periudhe të dhënat do të fshihen. Përfundimisht nga ky rregull bëjnë regjistrimet e bëra nga policia në përputhje me legjislacionin e veçantë.”

ç) Në shkronjën “dh” shprehja “sistem video regjistrimi” ndryshohet në “sistem të video survejimit”.

d) Në shkronjën “e” pas fjalëve “të të dhënave” shtohet fjala “personale”.

dh) Fjalja e dytë e shkronjës “f” ndryshohet si vijon:

“Këto të drejta janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996, si dhe me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.”

e) Shkronjat “g” dhe “gj” hiqen.

ë) Në shkronjën “h” fjalët “kontrolluesit dhe përpunuesit (personat e autorizuar)” ndryshohen në “kontrolluesit, përpunuesit dhe personat e autorizuar”.

5. Pika 5 ndryshohet si vijon:

“5. Kontrolluesit zbatojnë rregullat e mëposhtme për përpunimin e të dhënave personale me anë të sistemeve të video survejimit:

a) Në sektorin publik dhe privat që përdoren sisteme video survejimi, në hyrje të godinave zyrtare dhe të ushtrimit të aktiviteteve tregtare, me qëllim mbikëqyrjen e hyrjeve dhe daljeve për mbrojtjen e sigurisë së njerëzve dhe të pronës, për të mbrojtur sekrete dhe sekrete tregtare kur ky qëllim nuk arrihet në mënyra të tjera, lejohet përpunimi i të dhënave personale me anë të sistemeve të video survejimit vetëm me vendim me shkrim të organit kompetent zyrtar ose personi tjetër kompetent.

1. Për përpunimin e të dhënave me anë të sistemit të video survejimit, duhet që lloji, specifikimet e kamerave dhe vendosja e tyre të jenë në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren. Kameran nuk duhet të pozicionohet dhe të marrin imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

2. Është e ndaluar mbikëqyrja dhe regjistrimi i imazheve në ambiente private si ambiente sanitare, dhoma zhveshjeje.

b) Kameran në godinat e pallateve duhet vendosen me miratimin e 75% të banorëve, në zbatim të legjislatimit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.

1. Mbikëqyrja dhe regjistrimi i imazheve nëpërmjet sistemit të video survejimit në ambiente të përbashkëta të godinave me apartamente banimi, lejohet vetëm për qëllimin e sigurisë së njerëzve dhe të ruajtjes së pronës.

2. Ndalohet përhapja e imazheve të banorëve dhe aktiviteteve të tyre në ambientet e përbashkëta të banimit, të regjistruara nëpërmjet sistemit të video survejimit, përveç institucioneve si policia dhe prokuroria dhe me kërkesën e këtyre të fundit.

3. Ndalohet kontrollimi dhe transmetimi në kohë reale nëpërmjet internetit apo shërbimeve të tjera të ngjashme, i imazheve të regjistruara nëpërmjet sistemit të video survejimit, ku njerëzit janë lehtësisht të identifikueshëm nëpërmjet fytyrës.

4. Kontrolluesi detyrohet të vendosë në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga Komisioneri, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.”

Pas pikës 5 shtohet një pikë e re me këtë përmbajtje:

“6. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)



ZONË E MBIKËQYRUR ME KAMERA



_____ **EMRI I KONTROLLUESIT** _____
_____ **NR. I KONTAKTIT** _____

**Të gjitha subjektet e të dhënave personale mund të
ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr.9887, datë
10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”**

UDHËZIM
Nr.14, datë 22.12.2011

**PËR PËRPUNIMIN, MBROJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE NË
SEKTORIN E KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK TË PUBLIKUT**

Në zbatim të nenit 30 dhe shkronjës “f” pika 1 e nenit 31 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri

UDHËZON:

Neni 1
Fusha e veprimit

Ky udhëzim zbatohet për qarkullimin dhe vendndodhjen e të dhënave në këto dy subjekte: personat juridikë dhe personat fizikë, si dhe me të dhënat e nevojshme lidhur me identifikimin e abonentit apo përdoruesit të regjistruar.

Ky udhëzim nuk zbatohet për përmbajtjen e komunikimeve elektronike.

Neni 2
Qëllimi

Udhëzimi ka si qëllim sigurimin e një niveli të barasvlershëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe në veçanti të drejtën për privatësi, duke marrë parasysh përpunimin e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik dhe për të garantuar lëvizjen e lirë të të dhënave dhe të pajisjeve të shërbimeve të komunikimit elektronik në vend.

Neni 3
Qëllime specifike, të qarta dhe të ligjshme

1. Kontrolluesit që marrin të dhëna personale nga një subjekt i të dhënave, deklarojnë qartë që kanë për të përmbushur një ose më shumë qëllime specifike të ligjshme. Mbledhja e të dhënave në mënyrë rutinore dhe pa dallim është e kundërligjshme.

Neni 4
Përpunime të mëtejshme

1. Kontrolluesit që mbledhin të dhëna për një ose më shumë qëllime legjitime nuk mund t'i përdorin ato për ndonjë qëllim tjetër, përveç atyre për të cilin janë mbledhur.

2. Në mënyrë të ngjashme, ofruesit e shërbimit telefonik mbajnë të dhëna personale për qëllimin e sigurimit të një shërbimi telefonik për abonentë dhe funksionet lidhur me faturimet telefonike, riparimet e linjës. Ata janë të detyruar për të mbajtur lëvizjen dhe vendndodhjen e të dhënave deri dy vjet.

3. Në rast se një abonent i ndërpret marrëdhëniet me një ofrues të shërbimit telefonik, ofruesi i shërbimit nuk mund të përpunojë të dhënat personale të abonentit, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë. Përrjashtimi i vetëm është kur para përfundimit të kësaj marrëdhënieje, abonenti ka dhënë pëlqimin qartësisht për mbajtjen e kontakteve të tilla.



Neni 5

Të dhëna të mjaftueshme, të përshtatshme dhe jo të tepërta

1. Kontrolluesit duhet të vendosin kritere specifike për të vlerësuar se çfarë është e përshtatshme, e mjaftueshme dhe jo e tepërt dhe këto kritere zbatohen për çdo përpunim të të dhënave.
2. Kontrolluesit nuk mbledhin ose mbajnë të dhëna personale për të cilat ata nuk kanë nevojë, duke arsyetuar se të dhënat mund të përdoren në të ardhmen.

Neni 6

Parimet e mbrojtjes së të dhënave

1. Ofruesit e shërbimeve sigurojnë që në dispozicion të komunikimit elektronik publik, zbatohen parimet e sigurisë për sa u përket të dhënave që duhen ruajtur, si më poshtë:
 - a) të dhënat e mbajtura të jenë të cilësisë së njëjtë me ato të të dhënave në rrjet dhe subjektet gëzojnë të njëjtën siguri dhe mbrojtje të të dhënave të tyre;
 - b) të dhënat të jenë subjekt i masave të duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e tyre kundër shkatërrimit aksidental ose të paligjshëm, humbjes aksidentale, të magazinimit të paautorizuar apo përpunimit, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm;
 - c) të dhënat të jenë subjekt i masave të duhura teknike dhe organizative për të siguruar që ato të mund të aksesohen vetëm nga personeli i autorizuar; dhe
 - d) të dhënat, përveç atyre që janë në disponim dhe ruhen, të shkatërrohen në fund të periudhës së ruajtjes.

Neni 7

Përdorimi i të dhënave për marketingun e drejtpërdrejtë

1. Përdorimi i sistemeve të thirrjeve të automatizuara pa ndërhyrjen e individit, makinat e faksit ose posta elektronike për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë lejohet vetëm në lidhje me abonentë që kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, kur personi fizik ose juridik merr nga abonentët të dhënat elektronike për postën elektronike, në kuadër të shitjes së një produkti apo një shërbimi, i njëjti person fizik ose juridik i përdor këto detaje të kontaktit elektronik për tregtim të drejtpërdrejtë të produkteve të ngjashme ose të shërbimeve të veta, me kusht që abonentëve t'u jetë dhënë mundësia në mënyrë të qartë dhe dukshme, pa pagesë, për t'i refuzuar fillimisht përdorime të tilla.
3. Të dhënat, në lidhje me abonentët (persona fizikë), të përpunuara brenda rrjeteve elektronike të komunikimit që përmbajnë të dhëna për jetën private ruhen në atë masë dhe kohë që është e nevojshme për ofrimin e shërbimit për qëllime të ligjit dhe për ndërlidhje të pagesave.
4. Çdo përpunim i mëtejshëm i të dhënave të tilla nga ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, për tregtimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike ose për sigurimin e vlerës së shtuar të shërbimeve, lejohet vetëm nëse abonenti ka dhënë pëlqimin. Pëlqimi të jetë dhënë në bazë të informacionit të saktë dhe të plotë të dhënë nga ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut në lidhje me llojet e përpunimit të mëtejshëm që ka qëllim për të kryer. Abonenti ka të drejtën për të mos dhënë ose për të tërhequr pëlqimin e përpunimeve të tilla.
5. Në çdo rast, nuk lejohet praktika e dërgimit të postës elektronike për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë që fshehin identitetin e dërguesit, mbi të cilin komunikimi është bërë, ose pa një adresë të vlefshme në të cilin marrësi mund të dërgojë një porosi.
6. Të dhëna për trafikun e komunikimeve të përdorura për shërbime të tregtimit të drejtpërdrejtë ose për sigurimin e vlerës së shtuar të shërbimeve të fshehit ose të bëhet anonim pas ofrimit të shërbimit. Ofruesit e shërbimit mbajnë të informuar abonentët për llojet e të dhënave që janë përpunuar, qëllimet dhe kohëzgjatjen për të cilën kjo është bërë.

Neni 8

Konfidencialiteti i komunikimeve

Kontrolluesit garantojnë konfidencialitetin e komunikimeve dhe të të dhënave qarkulluese që kanë të bëjnë me të, sipas qëllimit të një rrjeti të komunikimit publik dhe shërbimit të komunikimit elektronik publikisht të disponueshëm, sipas legjislacionit kombëtar. Kontrolluesit ndalojnë dëgjimin, shtypjen, magazinimin ose lloje të tjera përgjimi ose mbikëqyrje të komunikimeve dhe të dhënave qarkulluese në fjalë nga persona të ndryshëm nga përdoruesit, pa dhënien e pëlqimit të përdoruesve të interesuar, përveç kur janë ligjërisht të autorizuar për të vepruar kështu.

Neni 9

Siguria dhe informimi mbi sigurinë

1. Ofruesit e shërbimeve marrin masat e duhura për të mbrojtur sigurinë e shërbimeve të tyre, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me ofruesin e rrjetit, dhe informojnë abonentët për ndonjë rrezik të veçantë të thyerjes së sigurisë së rrjetit.

2. Ofruesit e shërbimeve që ofrojnë në dispozicion të publikut shërbimet e komunikimit elektronik në internet informojnë përdoruesit dhe abonentët për masat që duhet të marrin për të mbrojtur sigurinë e tyre të komunikimit, për shembull duke përdorur lloje të veçanta të programeve, antiviruseve apo ndonjë mjet tjetër mbrojtës.

3. Kërkesa për të informuar abonentët për rreziqet e sigurisë së veçantë nuk e shkarkon një ofrues të shërbimit nga detyrimi për të marrë, me shpenzimet e veta, masat e nevojshme dhe të menjëhershme për të përmirësuar çdo rrezik të ri e të paparashikuar të sigurisë dhe të rivendosin nivelin normal të sigurisë së shërbimit.

Neni 10

Ruajtja e të dhënave

1. Kontrolluesit e të dhënave të jenë të qartë në lidhje me periudhën e kohës për të cilat të dhënat personale mbahen dhe arsyet përse informacioni është duke u mbajtur. Nëse qëllimi për të cilin merren të dhënat ka pushuar dhe informacioni personal nuk është më i nevojshëm, të dhënat fshihen ose tjetërsohen në një mënyrë të sigurt.

2. Të dhënat anonimizohen për të hequr çdo të dhënë personale. Në mënyrë që të përputhet me këtë kërkesë ligjore, kontrolluesit e të dhënave caktojnë përgjegjësi specifike dhe vendosin procedurat për të siguruar që dosjet të zbrazen rregullisht dhe se të dhënat personale nuk janë mbajtur më gjatë se sa ka qenë e nevojshme.

3. Orientimet në lidhje me shërbimin e komunikimit elektronik të publikut kanë të bëjnë vetëm për të dhëna të krijuara ose të përpunuara si pasojë e një komunikimi ose një shërbimi komunikimi dhe nuk kanë të bëjnë me të dhënat që ka përmbajtja e informacionit të komunikuar.

Neni 11

Numërori i abonentëve

1. Kontrolluesit sigurojnë që abonentët janë të informuar, pa pagesë, dhe para se ata të jenë përfshirë në numërorë, në lidhje me qëllimin e një numërori të shtypur apo elektronik të abonentëve, në dispozicion të publikut në të cilin përfshihen të dhënat e tyre personale dhe në çdo mundësi të mëtijshme të shfrytëzimit, bazuar në funksionet e kërimit të përfshira në versionet elektronike të numërorit.

2. Kontrolluesit sigurojnë që abonentëve u është dhënë mundësia për të përcaktuar nëse të dhënat e tyre personale janë të përfshira në një numëror publik dhe nëse po, masën për të cilat të dhëna të tilla



janë relevante për qëllimin e numërorit të përcaktuar nga dhënësi i numërorit, dhe për të verifikuar, korrigjuar ose për të tërhequr të dhëna të tilla.

3. Për çdo qëllim të një numërori publik ndryshe nga kërkimi i detajuar i kontaktit të personave në bazë të emrit të tyre dhe, kur është e nevojshme, një minimum prej identifikuesve të tjerë, t'i kërkohet pëlqim shtesë abonentëve.

Neni 12
Të fundit

1. Janë përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi të gjithë kontrolluesit publikë e privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

UDHËZIM
Nr.15, datë 23.12.2011

PËR PËRPUNIMIN DHE PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SISTEMIN
GJYQËSOR

Mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe shkronjën “f” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

KREU I
OBJEKTI

1. Ky udhëzim përcakton drejtimit kryesore në përpunimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor, marrjen e masave për sigurinë e të dhënave personale, gjatë dhe pas përpunimit, si dhe publikimin e tyre.

KREU II
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjykatat janë kontrolluese, sepse mbajnë, përpunojnë, administrojnë, publikojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhënat personale.

2. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

3. Gjatë përpunimit të të dhënave në sistemin gjyqësor, është e rëndësishme të respektohet parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe qëllimit të mbledhjes së tyre. Të dhënat personale mblidhen vetëm për qëllime specifike, të qarta dhe të ligjshme në kuadër të përmbushjes së detyrave të këtij sistemi dhe përpunohen vetëm për të njëjtin qëllim për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

4. Sistemi gjyqësor përpunon të dhënat personale dhe sensitive, në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale të parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të paragrafit 1 të nenit 6 dhe në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale gjatë përpunimit të tyre, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

6. Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit dhe publikimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim kontrolluesit për dëmin e shkaktuar.

7. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me atë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU III

MASAT E SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI

1. Administrata gjyqësore merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale bëhet veçanërisht në përputhje me këto masa sigurie:

a) Refuzohet akses i personave të paautorizuar në pajisjet e përpunimit të të dhënave të cilat përdoren për përpunim të të dhënave personale (qasje në pajisjet e kontrollit);

b) Parandalohet leximi, kopjimi, modifikimi apo fshirja e paautorizuar e të dhënave;

c) Parandalohet hedhja e paautorizuar e të dhënave dhe inspektimi, modifikimi ose fshirja e paautorizuar e të dhënave personale të ruajtura;

ç) Regjistrohen dhe dokumentohen modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet;

d) Parandalohet përdorimi i sistemeve të automatizuara të përpunimit të të dhënave nga ana e personave të paautorizuar;

dh) Sigurohet që personat e autorizuar për të përdorur një sistem të automatizuar (elektronik) të përpunimit të të dhënave, të kenë akses vetëm në të dhënat e mbuluara nga autorizimi për akses;

e) Sigurohet se është e mundur për të verifikuar dhe për të përcaktuar se në cilat organe janë ose mund të transmetohen ose të vihen në dispozicion të dhënat personale duke përdorur pajisjet e komunikimit;

ë) Sigurohet se është plotësisht i mundur verifikimi dhe përcaktimi se cilat të dhëna personale janë hedhur në sistemet e automatizuara të të dhënave, kur dhe nga kush janë hedhur të dhënat;

f) Parandalohet leximi, kopjimi, modifikimi, korrigjimi ose fshirja e paautorizuar e të dhënave personale gjatë transferimit të tyre ose gjatë transportimit të dosjeve gjyqësore;

g) Sigurohet që sistemet e instaluar, në rast të ndërprerjes, të mund të rikthehen;

h) Sigurohet që sistemi funksionon në mënyrë të rregullt, se paraqitja e defekteve në funksione është raportuar dhe se të dhënat e ruajtura nuk mund të preken nga një mosfunksionim i sistemit.

3. Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale.

4. Dokumentacioni me të dhënat personale mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për përmbushjen e qëllimit për të cilin janë grumbulluar.

5. Të punësuarit në sistemin gjyqësor dhe të tjerë, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Shkelja e detyrimit të konfidencialitetit përbën vepër penale të parashikuar nga Kodi Penal (neni 123).



KREU IV PUBLIKIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

1. Të dhënat personale ose sensitive që përmban vendimi gjyqësor, bëhen publike vetëm nëse nga ky publikim nuk cenohen interesat legjitimë të subjekteve të të dhënave.

2. Subjekti i të dhënave personale informohet mbi të dhënat e tij, të cilat do të publikohen me initiale ose të koduara në faqen zyrtare në internet sipas këtij udhëzimi, me qëllim bërjen e tij të paidentifikueshëm.

3. Përpara publikimit dhe vënies në dispozicion të publikut, personat përgjegjës kujdesen për të siguruar që të dhënat personale në vendimet gjyqësore të jenë të sakta dhe të plota. Nëse verifikohet se të dhënat personale në vendimet gjyqësore të papublikuara janë të pasakta ose të paplota, për korrigjimin apo fshirjen e tyre, personi përgjegjës konsultohet me gjyqtarin e çështjes. Pas këtij konsultimi, korrigjimi, fshirja apo bllokimi kryhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile (të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat e mëposhtëm, në mbrojtje të privatësisë:

a) Gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me initiale ose kodohen.

b) Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohet publikimi i të dhënave personale që cenojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave).

5. Gjatë publikimit të vendimeve civile tregtare, gjeneralitetet e palëve/aksionarëve paraqiten me initiale ose kodohen, ndërsa ndalohet publikimi i përqindjeve të aksioneve/kuotave që zotërojnë palët, i numrave të llogarive bankare, shumat (vlerat) monetare dhe sekretet tregtare.

6. Gjatë publikimit të vendimeve civile familjare, gjeneralitetet e palëve ndërgjygjëse paraqiten me initiale ose kodohen, ndërsa ndalohet publikimi i rrethanave që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të tyre ose personave të tjerë të lidhur me çështjen gjyqësore, si dhe i të dhënave, mbi dhënien e mendimit të fëmijës, mbi detyrimin ushqimor, mbi takimet e të miturit me prindërit, kohën dhe vendin e takimit, mbi raportin e psikologut, etj.

7. Në të gjitha rastet kur palët në gjykim janë minorenë, ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe të dhënave të tjera identifikuese (personale) ose të dhënave lidhur me të tretë, nga të cilat mund të zbulohet edhe indirekt, identiteti i minorenit.

8. Aksesit në vendimin e plotë të publikuar në faqen zyrtare në internet lejohet vetëm për personat që kanë një interes të ligjshëm në të.

9. Kopja fizike e vendimit gjyqësor i jepet vetëm personave të interesuar që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me çështjen gjyqësore.

10. Kur vendimet gjyqësore të formës së prerë përdoren për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie atëherë, për përpunimin e të dhënave të parashikuara në këto vendime zbatohen kërkesat e neneve 10 dhe 11 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet kontrolluesi/titullari i tij të përcaktojë personin/personat përgjegjës, referuar në kreun IV të këtij udhëzimi, si dhe detyrat përkatëse të tij/tyre në përmbushje të zbatimit të këtij kreu.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha strukturat përkatëse të kontrolluesit, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi gjashtë muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISONERE
Flora ÇABEJ (POGAÇE)

**KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.2367/3, datë 22.12.2011**

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë (loti 7 rrugët dytësore, tokat).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Pronarët për të cilët është bërë shënimi “Në proces regjistrimi nga ZRPP” do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë DPRR-së.

Për pasuritë për të cilat nuk ka konfirmim nga ana e ZVRPP-së sqarojmë se personat të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 130 900 655 (njëqind e tridhjetë milionë e nëntëqind mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I BY-PASS “PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË”
Loti 7 me rrugët dytësore dhe mbikalim (tokat)

Nr.	Pronari		Zona kad.	Nr. pas	Sip. m²	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	Mbiemri							
1	B/pronare	Xhahysa	3554	299/39	383	arë	377	144391	I pakonfirmuar
2	Petrit	Todia	3554	299/19	840	arë	377	316680	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Ali	Todia	3554	299/18	43	arë	377	16211	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Asllan	Todia	3554	299/20	174	arë	377	65598	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Zyber	Çullhaj	8552	1/153	959	truall	16700	16015300	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Gezim	Çala	8552	1/165	206	truall	16700	3440200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Xhaferr	Zhelegu	8552	1/154	1630	truall	16700	27221000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	B/pronare	Biturku	8552	1/150	300	truall	16700	5010000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Rustem	Kaja	8552	10/63	232	arë	359	83288	I pa konfirmuar
10	I paidentifikuar		8552	10/51	221	arë	359	79339	I pa konfirmuar
11	Shaqir	Kollcaku	8552	1/---	65	arë	359	23335	I pa konfirmuar
12	I paidentifikuar		8552	10/6	754	arë	359	270686	I pa konfirmuar
13	I paidentifikuar		8552	10/8	408	arë	359	146472	I pa konfirmuar
14	Agron	Elezi	8552	10/50	117	truall	16700	1953900	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Khavit	Kollcaku	8552	10/232	164	arë	359	58876	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Jakup	Kollcaku	8552	10/62	498	truall	16700	8316600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	Idriz	Kollcaku	8552	10/61	258	truall	16700	4308600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	Muharrem	Kollcaku	8552	10/60	321	truall	16700	5360700	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	Jani	Papa	8552	12/287	300	arë	359	107700	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	Astrit	Hallulli	8552	12/289	244	arë	359	87596	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	Tasim	Dervishaj	8552	12/290	212	arë	359	76108	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
22	Qani	Hoxha	8552	12/291	153	arë	359	54927	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	Qani	Hoxha	8552	12/253	146	truall	14800	2160800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24	Aleksander + Marieta	Proda	8552	12/315	291	truall	14800	4306800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	Aviol	Pepa	8552	12/257	760	arë	359	272840	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	Sulejman	Allajbej	8552	12/297	125	arë	359	44875	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	Idriz	Kasa	8552	12/298	178	arë	359	63902	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	Vullnet	Kollcaku	8552	12/296	424	arë	359	152216	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
29	Avni	Lila	8552	12/311	609	truall	14800	9013200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	Besnik	Allajbej	8552	12/274	250	arë	359	89750	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

31	Hashim	Kurti	8552	12/278	388	arë	359	139292	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	Edi	Hasalliu	8552	12/330	263	arë	359	94417	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	Rexhep	Çeka	8552	12/307	238	arë	359	85442	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	Rexhep	Çeka	8552	12/309	253	arë	359	90827	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	B/pronare	Hoxha	8552	12/331	450	arë	359	161550	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	Fatbardha	Perja	8552	12/231	237	arë	359	85083	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	Fatbardha	Perja	8552	12/230	227	arë	359	81493	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
38	Hafsa	Biba	8552	12/314	230	arë	359	82570	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
39	Luan	Zoto	8552	12/312	257	arë	359	92263	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	Shqipe	Kazazi	8552	12/284	203	arë	359	72877	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	Ismet dhe Arben	Oxhallari	8552	12/293	670	arë	359	240530	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	Drimon Dedej Artan Shyti		8552	12/299	390	arë	359	140010	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
43	B. Duhanxhiu Gentian Lila		8552	12/44	360	truall	14800	5328000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
44	I paidentifikuar		8552	12/7	133	arë	359	47747	I pakonfirmuar
45	B/Pr Bekshiu		8552	12/133	50	arë	359	17950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
46	B/Pr Bekshiu		8552	12/134	50	arë	359	17950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
47	B/Pr Bekshiu		8552	12/135	50	arë	359	17950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
48	B/Pr Bekshiu		8552	12/136	160	arë	359	57440	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
49	Dhurata	Cara	8552	12/137	395	arë	359	141805	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
50	Qefsere	Velecia	8552	12/206	392	arë	359	140728	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
51	Naime	Popoj	8552	12/211	400	arë	359	143600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	Mirsie	Metolli	8552	12/212	379	arë	359	136061	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
53	Qazim	Okshtuni	8552	12/213	410	arë	359	147190	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
54	Flamur	Okshtuni	8552	12/214	400	arë	359	143600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
55	Ardian	Bacaj	8552	12/215	818	arë	359	293662	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
56	Vasip	Okshtuni	8552	12/324	568	arë	359	203912	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
57	Ylli	Sinani	8552	12/321	52	arë	359	18668	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
58	Hidajet	Xhihani	8552	12/322	643	arë	359	230837	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
59	Vasip	Okshtuni	8552	12/323	627	arë	359	225093	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
60	Rasim	Okshtuni	8552	12/326	207	arë	359	74313	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
61	Rasim	Okshtuni	8552	12/325	777	arë	359	278943	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
62	I paidentifikuar		8552	12/210	274	arë	359	98366	I pakonfirmuar
63	Mirazh	Shkodra	8552	18/362	641	truall	14800	9486800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
64	Mirazh	Shkodra	8552	18/361	1258	truall	14800	18618400	Proces Regjistrimi
65	Fatos + Vullnet	Demrozi	8552	18/6	41	truall	14800	606800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
66	Xhevat	Hoxha	8552	18/370	24	arë	359	8616	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
67	Xhevat	Hoxha	8552	18/367	32	arë	359	11488	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
68	Xhevat	Hoxha	8552	18/373	128	arë	359	45952	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
69	Naxhie	Dimni	8552	18/307	106	arë	359	38054	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
70	Limon	Celislami	8552	18/308	252	arë	359	90468	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
71	Indrit	Çela	8552	18/403	188	arë	359	67492	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
72	Indrit	Çela	8552	18/406	197	arë	359	70723	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
73	Nazmi + Hamid	Arkaxhiu	8552	18/401	252	arë	359	90468	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



74	I paidentifikuar		8552	18/301	477	arë	359	171243	I pakonfirmuar
75	Reshat	Dimni	8552	18/404	239	arë	359	85801	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
76	Hamdi	Myftiu	8552	18/425	670	arë	359	240530	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
77	Artur	Simaku	8552	18/360	540	arë	359	193860	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
78	Ylber	Demrozi	8552	18/349	135	arë	359	48465	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
79	Ylber	Demrozi	8552	18/352	151	arë	359	54209	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
80	Shaban + Rabihane	Xhihani	8552	18/216	230	arë	359	82570	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
81	Noljan	Muçolli	8552	18/218	250	arë	359	89750	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
82	B/pr Kazazi		8552	18/280	130	arë	359	46670	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
83	B/pr Kazazi		8552	18/284	112	arë	359	40208	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
84	Selim	Zenelaj	8552	18/286	136	arë	359	48824	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
85	Selim	Zenelaj	8552	18/282	170	arë	359	61030	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
86	Zequine	Lilamani	8552	18/359	404	arë	359	145036	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
87	Arben	Alia	8552	18/424	420	arë	359	150780	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
88	Afrim	Lilamani	8552	18/293	292	arë	359	104828	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
89	Bledar	Rrokja	8552	18/410	181	arë	359	64979	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
90	Bujar	Bogdani	8552	18/411	242	arë	359	86878	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
91	Kujtim	Xhuti	1212	145/15	515	arë	342	176130	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
92	Dritan	Hushi	1212	145/13	550	arë	342	188100	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
93	Lutfi	Kalaja	1212	145/29	287	arë	342	98154	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
94	Sonila	Goreja (Kalaja)	1212	145/26	568	arë	342	194256	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
95	Xhavit	Shima	1212	145/28	197	arë	342	67374	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
96	Petrit	Adhjari	1212	145/16	291	arë	342	99522	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
97	B/Pr Kalaja		1212	145/24	300	arë	342	102600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
98	Shoq. Transp. Kavaqe		1212	145/30	496	arë	342	169632	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
99	Rakip	Daka	1212	162/5	110	arë	342	37620	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
100	Arjan	Kalaja	1212	145/23	134	arë	342	45828	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
101	Rukije	Haveriku	1212	162/12	275	arë	342	94050	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
102	Nexhatie	Gugashi	1212	162/13	300	arë	342	102600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
103	Muharrem	Kalaja	1212	145/22	314	arë	342	107388	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
104	Nafije	Cara	1212	162/34	510	arë	342	174420	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI					34961			130900655	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.1.2012
Doli nga shtypi më 15.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë